



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2018, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me universitetet publike të rretheve.
2. Shqyrtimi i kërkesës së AMA-s për lirimin nga detyra të anëtarit të AMA-s, Zylyftar Bregu, për shkelje të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Almira Xhambulla, Adelina Rista, Bujar Çela, Besnik Baraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj, Nora Malaj.

Të ftuar:

Adem Bekteshi – rektor i Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër,
Ksanela Sotirofski – rektore e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës,
Jani Dine – zëvendësrektor i Universitetit "Eqerem Çabej" Gjirokastrë,
Mirela Bimo – drejtore në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëdita!

Faleminderit shumë që keni ardhur!

Këtu kemi prezentë nga Universiteti e Shkodrës, zotin Adem Bektashi, nga Universiteti i Durrësit, zonjën Ksanela Sotirofski, nga Universiteti i Gjirokastrës, zotin Jani Dine. Të tjerët nuk na kanë ardhur. Rektori i Vlorës na lajmëroi se është në një konferencë, e cila nuk ka mbaruar ende, ka sjellë disa shënime me shkrim, pra, në një mënyrë është prezent në formë virtuale. Nuk e di a keni marrë ndonjë konfirmim nga universitetet e tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sot në mëngjes, para se të bënim dëgjesën me ju, kishim një dëgjesë me Universitetet e Tiranës, kishim prezentë zotin Gjata, zotin Koni dhe zotin Cuka, që bënë një paraqitje të projektbuxhetit për vitin 2019. Ishin edhe administratorët e bordeve të universiteteve, si edhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit. Një nga këshillat që na u dha duke filluar që nga hera tjetër e tutje, do të ishte mirë që kur kemi dëgjesa që lidhen me projektbuxhetin e universiteteve, të kishim prezent edhe administratorin, sepse ju jeni më tepër përgjegjës për çështjet e akademisë, ndërsa ata janë më tepër përgjegjës për çështje që kanë të bëjnë me administrimin e fondeve. Ne do ta vëmë “vath në vesh” këtë gjë dhe do ta kemi parasysh për herë tjetër, kur t’ju thërrasim në dëgjesa.

Përpara se t’ju japim fjalën juve, do të kërkoja nga zoti Ylli të thotë nëse e kemi arritur kuorumin, apo jo. Jemi në rregull për të vazhduar këtë mbledhje?

Fidel Ylli - Kuorumi është i plotë, ne jemi 10 anëtarë të komisionit. Pra, mund të vazhdojmë normalisht mbledhjen.

Milva Ekonomi - Faleminderit!

Ju e keni parë projektbuxhetin për këtë vit dhe mund të na thoni disa opinione që keni për këtë gjë.

Fjalën mund ta merrni si të dëshironi.

Adem Bektashi – Përshëndetje!

Jam rektor i Universitetit të Shkodrës.

Ju falënderoj për ftesën!

Është hera e dytë që vijmë në këtë komision. Edhe vjet paraqitëm disa nga nevojat që kishte universiteti, jo vetëm ai i Shkodrës, por të gjithë me radhë se ishim të gjithë në rresht dhe nuk u parashikuan në buxhetin e vitit të kaluar. Me thënë të drejtën nuk shpresoj se edhe në këtë buxhet do të parashikohen nevojat tona, por duke pasur parasysh ligjin e ri “Për arsimin e lartë”, vendimin e KM-së për gradat, titujt shkencorë dhe vendimet e tjera, qoftë edhe udhëzimet e ministries, është bërë jashtëzakonisht e nevojshme që në buxhetin e universitetit të parashikohet granti për kërkimin shkencor. Ne kemi kërkesa nga pedagogët, që nuk mund t’i realizojmë nga buxhetet e universiteteve. Pedagogët kërkojnë pjesëmarrjen në konferenca, botime të nivelit të lartë, faktorë impakti që të gjitha janë me pagesë. Po kështu një pjesë e pedagogëve tanë që nuk e kanë gradën shkencore, kërkojnë të hyjnë në projektet shkencore të doktoraturës, të cilat, siç dihet, janë projekte që konkurrohen, por ministria nuk po i hap. Nuk e dimë këtë pjesë, sa do të vihet në buxhetin tonë. Ne si universitet për vitin në vazhdim, për 2018-ën kemi parashikuar një fond jo të madh, dhe jo për të bërë kërkim të pastër nëpër laboratorë, por vetëm pjesëmarrje në konferenca dhe botime në revista me faktorë impakti janë 4 milionë lekë të rinj. Pra, është shumë e vogël, ta themi ndershmërisht, për numrin e pedagogëve që kemi; për kërkesat që janë, na duhet të bëjmë seleksionime. Do të thoni ju vini më shumë, vini më pak, por universitetet kanë shumë probleme. Nuk po them problemet që ka Universiteti i Shkodrës. Ku duhet t’i çojmë ato para që marrim nga buxheti? Është e domosdoshme që në buxhetin e Ministrisë së Arsimit, agjencia nuk po funksionon, të vihet një fond fillestar. Ne, si të gjithë universitetet e tjera, jemi duke marrë pjesë në projekte jo tamam shkencore, kryesisht janë projekte për riorganizime, për trajnime. Ndoshta është shkak se ne nuk kemi infrastrukturën dhe kapacitetet e duhura për të qenë drejtues të projekteve, por jemi gjithmonë partnerë. Pjesa që marrim nuk i përgjigjet hapjes ose shtrimit të një problemi që të futen pedagogë nga kërkimi shkencor. Dëshira është e madhe, kërkesat janë të mëdha, por ne nuk i kemi mundësitë.

Sapo bisedova me administratoren, do të ishte mirë të ishte këtu. Ajo tha se është bërë kërkesa, por fondi që vjen, vjen vetëm për pagat dhe për sigurimet. 10% e fondit shkon për bursat e studentëve. Për kërkimin shkencor ne nuk na lejohet të vëmë asgjë nga fondi që vjen nga qeveria. Shpresojmë që për këtë vit, të jetë jo një çekiç si ajo e vitit të kaluar, por dy çekiçë, se me dy çekiçë mbyllet seanca. Vëmendja nga ana juaj të jetë pak më e madhe në aspektin e rigjallërimit të jetës shkencore në universitete.

Nëse keni ndonjë pyetje specifike për Universitetin e Shkodrës, jam i gatshëm që t'i diskutojmë.

Faleminderit!

Ksanela Sotirofski - Përshëndetje!

Problemet e universiteteve publike pothuajse janë të njëjta dhe gjëja që na shqetëson më shumë ne rektorëve është granti specifik për kërkimin shkencor. Nga granti që na ka ardhur nga buxheti i shtetit vitin e kaluar, nuk kemi pasur asnjë lek që mund të ketë tepruar për t'u shpërndarë pedagogëve për të konkurruar me projekte shkencore.

Gjë tjetër që dua të theksoj specifikisht është Universiteti i Durrësit, i cili është një universitet i ri publik. Ai është hapur në vitin 2006 me 300 studentë dhe sot numëron 2000 studentë. Kemi një kampus universitar prej 55 hektarësh tokë. Mendoj se duhet të na ndihmoni të vazhdojmë me rrethimin e atij kampusi, me ndërtimin e godinave të konvikteve dhe të kemi infrastrukturë mbështetëse në shërbim të studentëve në kampusin universitar.

Diçka tjetër që dua të kërkoj është rregullimi i përdorimit të të ardhurave dytësore nga universitetet publike. Ne kemi një ligj "Për arsimin e lartë", i cili na nxit që profesorati të ketë mundësi të fitojë para, të cilat do të jenë në shërbim të universitetit, por edhe të kërkimit shkencor. Por praktikisht ne nuk kemi asnjë akt, i cili rregullon mënyrën e shpërndarjes së këtij fondi midis universitetit dhe stafit akademik.

Këto janë pak a shumë ato që doja të theksoja, sepse të gjithë rektorët kanë folur për të njëjtat gjëra.

Milva Ekonomi - Zoti Dine keni për të shtuar?

Jani Dine - Faleminderit!

Jam zëvendësrektor në Universitetin e Gjirokastrës. Pak a shumë, problemet janë të njëjta. Në projektbuxhetin e vitit 2019 universiteti ynë nuk e gjen veten në asnjë prej këtyre zërave. Ajo që na bashkon me të gjitha universitetet është pjesa e përbashkët, ajo që thanë edhe kolegët. Ndoshta nuk është vendi, por shpeshherë universiteti ynë ka bërë një kërkesë të vazhdueshme për një shtëpi të oficerëve, që i ka kaluar si godinë Universitetit të Gjirokastrës. Është bërë kërkesë herë pas here për një fond për ta rikonstruktuar këtë godinë, pasi jemi në kushte të vështira, mësimi zhvillohet pasdite. Është planifikuar një godinë, është bërë kërkesa, projektet, por jemi në pritje të çeljes së fondit për rikonstruksionin e saj.

Milva Ekonomi – Ka pyetje për rektorët?

Besnik Baraj- Të them të drejtën kur dëgjoj vlerat që tha edhe Ademi, më duken jo vetëm minimaliste, por është pasqyrë e këtij niveli zhvillimi që ka vendi ynë. Ndoshta është e tepërt të them që asnjë vend në botë nuk ka pasur nivele të mëdha zhvillimi ekonomik dhe social, pa u investuar vite përpara në drejtim të forcimit dhe ngritjes së kapaciteteve të universiteteve. Është keqardhje që dëgjoj nga biznese të ndryshme kur thonë: “Ne nuk kemi sot specialistë, inxhinierë ndërtimi, arkitektë në standardet që i kërkojnë kompanitë e huaja që vijnë në Shqipëri”. Një nga arsyet, për mua është fakti se universitetet përtej propagandës janë lënë pas dore.

Kam parasysh universitetin që drejton Ademi, edhe fakultetin ku unë kam vazhduar të jap mësim. Pa punë shkencore, ajo nuk është më shkollë e lartë, pa një mbështetje të pjesës eksperimentale, të këtyre shkencave, laboratorëve nuk nxjerrë kurrë inxhinierë kimistë, biologë në nivelin që duhet. E ngjashme është situata edhe në Universitetin Politeknik, ku duhet inxhinieri dhe pjesa eksperimentale, me ato vlera kurrë nuk mund të ketë një universitet solid kompetitiv, që të nxjerrë njerëz, të cilët u përgjigjen sfidave të kohës.

Mua personalisht më duken minimaliste këto kërkesa dhe do të them që si komision t’i mbështesim, pasi është një investim jashtëzakonisht i rëndësishëm. Më besoni, sepse vazhdoj të jap mësim, ne vazhdojmë të nxjerrim studentë skarco. Një nga arsyet është për shkak të mungesës së përkrahjes. Një nga ato shembuj është edhe kjo që përmendi kolegja nga Durrësi, dalja e një vendimi apo akti normativ, nuk e di se çfarë, që rregullon marrëdhëniet financiare ndërmjet të tretëve, buxhetit të dekanatit dhe vetë profesorit. Ne nuk po kërkojmë të shpikim gjëra, por kërkojmë gjëra për të cilat modelet ekzistojnë shumë mirë në universitetet e tjera në botë. Pse duhet të shpikim?

Më falni, nuk e kam për ju! Ndodh që rektorët krijojnë një lloj monopoli në këtë drejtim dhe nuk bëjnë një shpërndarje efektive të burimeve kur i kanë, por pa dyshim ju mbështes në atë që duhet patjetër të ketë vendime, të cilat rregullojnë marrëdhëniet financiare ndërmjet të tretëve, dekanatit, rektoratit, katedrës dhe individit. Duhet të stimulohet, ai duhet të shkojë patjetër deri te profesori, deri tek ai që bën punën shkencore, bashkë me ekipin e studentëve, të kolegëve e të tjera.

Pa dyshim që i mbështes kërkesat e tyre.

Milva Ekonomi- Faleminderit, zoti Baraj!

Unë dua të them se edhe në dëgjesën para jush me Universitetin e Tiranës, këto ishin çështjet që ngritën: sasinë e grantit që jepet nga ministria, ndarjen e granteve për kërkimin shkencor. Ne dëgjuam që për kërkimin shkencor Agjencia Kombëtare për

Kërkimin Shkencor ka shpallur një garë, ka disa muaj dhe ende nuk ka marrë një vendim për projektet më të mira që kanë fituar. Nuk e di nëse universitetet tuaja kanë qenë pjesë e këtyre garave. Stimuluam që kjo gjë të tejkalohet, duke qenë se janë edhe përfaqësuesit e ministrisë këtu.

Çështja tjetër është ajo e investimeve, ku disa universitete të Tiranës, ai i Sporteve, kishte nevojë urgjente për investime kapitale më tepër sesa universitetet e tjera, ndërkohë që kishte nevojë për investime Universiteti i Mjekësisë, që e kishte pak afatgjatë, por edhe për këto morëm një përgjigje që duam t'juja vëmë edhe ju në dijeni, bëhet fjalë për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve. Nëse universitetet së bashku me ministrin përgjegjës dhe me kryetarët e bashkive nga vijnë universitetet kanë mundësi të paraqesin një projekt të mirë për të qenë konkurrent të Fondi, do t'ju nxisnim shumë që ta bënit këtë gjë.

Nëse kolegët nuk kanë pyetje, unë do të them se ne morëm një angazhim si ky që sapo tha zoti Baraj, do të ulemi do të bëjmë një raport definitiv për Komisionin e Ekonomisë dhe do të diskutojmë siç bëmë edhe vjet; zërin tonë për më shumë mbështetje e kemi ngritur edhe vjet. Ne kemi për detyrë që të këmbëngulim për më shumë buxhet për universitetet. Duke pasur këtë situatë, që ju keni nevojë për një grant, në terma makro, pra pak më i lartë dhe për investime, të bëjmë edhe ne rekomandime për këta zëra që keni nevojë.

Adem Bekteshi - Më falni!

Po ndërhyj edhe një herë. Universiteti i Shkodrës ka aplikuar me dy projekte në Fondin e Zhvillimit për vitin në kalim, e fitoi njërin. Një projekt e kemi marrë nga ky Fond nga Ministria e Arsimit, por dua të them se na u premtua një fond për mobilimin e një godine, që nuk erdhi, është një godinë e re 6 -katëshe, pjesa më e madhe e buxhetit të këtij viti ka shkuar për të, sepse nuk mund ta lëmë pa e bërë.

Vjet, nga mesi i shkurtit, ka qenë në Universitetin tonë zoti Rama, i cili na e premtoi këtë gjë. Deri në majin e këtij viti, e kam ndjekur atë fond, por nuk më ka ardhur. Vjet kam thënë në dëgjese se qeveria na ka dhënë fonde, janë të regjistruara, sepse m'u dha fjala. Duhet ta dini se t'i heqësh 50 milionë të rinj universitetit për një investim që i është premtuar është një shumë jashtëzakonisht e madhe, duke menduar që universitetet jetojnë me buxhete që krijohen nga bachelori që është 200 mijë lekë të vjetër maksimumi 250 mijë lekë të vjetër në vit.

Nuk flasim dot për universitete që kanë numër gjigand studentësh, vetëm Tirana e ka këtë, por ne të rretheve jetojmë me numra të vegjël, (ka 20 mijë profesoresha, edhe 12 mijë ka Shkodra), por një pjesë e madhe e tyre janë studentë të fshehur që nuk vijnë, e

shtyjnë shkollën për të mos paguar tarifën e shkollimit. Aktualisht në Shkodër mund të ketë 6-7 mijë studentë, që janë të rregullt. A e imagjinoni dot se çfarë bëhet me atë buxhet? Aq më tepër të bëhet investim? Këtë unë e kam zbatuar vetëm e vetëm që të vihet në funksionim godina, një godinë 6-katëshe që mbeti pa funksion. Nuk është problemi se universitetet nuk aplikojnë. Ne kemi dërguar 10 projekte. Jam i bindur se një projekt mund të vijë për universitetin, sepse e gjitha varet te sasia e grantit që ka Agjencia, nuk është problemi nëse kemi dërguar projekte apo jo. Ne kemi dërguar 2, morën 1 projekt. I kemi falënderuar të gjithë, por nëse do të flasim për situatën në investime, duhet të bëhet shumë kujdes, veçanërisht universiteteve që nuk janë të rinj, sepse godinat tona janë të amortizuara. Ne i mirëmbajmë vetëm me ato fonde që mbledhim. Për të bërë investime të tilla si mobilimi, merr më shumë se gjysmën e buxhetit që kemi për të shfrytëzuar për universitetin, nuk duhet të lihem në këto kushte, por duhet të ndihmohemi.

Pra, nuk është se universitetet nuk marrin pjesë, ato marrin pjesë me shumë projekte, por të themi të drejtën ka raste që nuk mund të bëhen të gjitha me projekte, duhet edhe qeveria të bëjë investim direkt.

Milva Ekonomi - Do të bëjmë më të mirën tonën për të ngritur zërin, që të keni mbështetjen siç e meritoni. Por nuk jemi vetëm ne.

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ju falënderojmë shumë për prezencën, sepse ishte shumë e rëndësishme!

Punë të mbarë dhe suksese!

Kemi edhe dy çështje të tjera. Një propozim nga ana ime, nisur nga dëgjuesat, për relacion kemi lënë një relator, vjet kemi pasur dy relatorë, nuk ka lidhje vjet apo sivjet, por mendoj se duhet të shtojmë edhe një relator për pjesën e universiteteve, pasi e kuptuam nga diskutimi i mëngjesit dhe tani që ka nevojë të përpunojmë disa çështje për universitetet. Pamë që edhe ministria vetë nuk e mbronte dot grantin që kalonte, as investimet. Pra, do të na duhet ta përpunojmë pak më mirë këtë gjë. Do të shtojmë dhe një relator për çështjen e universiteteve? Cilin mendoni të caktojmë si relator?

Vilma dhe Ismeti bëhuni gati që të angazhoheni për të bërë një paragraf siç duhet për universitetet.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2018, ora 13:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Shqyrtimi i kërkesës së AMA-s për lirim nga detyra të anëtarit të AMA-s, Zylyftar Bregu, për shkelje të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Almira Xhambulla, Adelina Rista, Bujar Çela, Besnik Baraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj, Nora Malaj.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi - Çështja tjetër që kemi është çështja “Bregu” që e diskutuam, që në fillim të mbledhjes së parë, për ta futur sot në rendin e ditës. Sekretaria e komisionit e ka lajmëruar për të ardhur për dëgjuesë nesër, z. Bregu, kemi caktuar orën 13:00. Ai ende nuk

është përgjigjur, por dua t'ju them që kur të jetë zoti Bregu në dëgjese, duhet të merrni masa që të mos mungoni; duket si dëshirore, por është angazhim për komisionin, është urdhër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që do të jemi, por po e them me zë. Për shembull, tani Fatmirin nuk e kemi prezent dhe u detyruam të marrim zëvendësuesin, zotin Baraj, për të vazhduar mbledhjen. Do t'ju lutem shumë që të mos ketë më gjëra të tilla.

Një çështje tjetër që kemi në rendin e ditës është letra që ka dërguar zoti Limoz Dizdari, ku kërkon mbështetje financiare për të përmirësuar qendrën e tij “Dea”. Pra, letra ka ardhur nga zoti Dizdari. Me ndihmën mbështetëse të sekretarisë së komisionit arrita të gjej statusin që ka kjo qendër. Sapo hymë në QKR, statusi është forma ligjore sh.p.k. Është themeluar në vitin 1999 dhe është një investim privat, por produkti që nxjerr kjo qendër është e mirë publike, sepse prodhon art për banorët apo për turistët që shkojnë në atë zonë. Ai ka bërë një kërkesë dhe kërkon të vendosë një teatër të vogël për muzikë dhome a balet. Kërkesën e tij e sjell me disa rekomandime që vijnë nga artistë të shquar. Është një listë me rekomandime. Ju keni përpara nga një kopje. Këto rekomandime vijnë nga: zoti Pajtim Çausi, zoti Dashamir Malo, kryetar i grupit të krijuesve jonianë, zonja Inva Mula, zonja Nora Çashku, zoti Eno Koço, zoti Nasho Jorgaqi, zoti Edmond Dingu dhe zoti Xhevat Lloshi. Ka edhe një letër pa emër, nuk e kuptoj se cili e ka sjellë. Janë zoti Namik Dokle dhe zoti Arben Malaj.

Unë nuk e di se si veprohet me një rekomandim, sepse ajo është një qendër private, sapo bëjnë ndjekjen në QKR, dhe prodhon një produkt publik. Nuk e di në një rast si ky se si veprohet dhe ta mbështesim për të bërë një kërkesë për buxhetim apo jo. Unë mendoj që çështjen në fjalë t'ia japim Shërbimit të Legjislacionit në Kuvend. Pastaj të angazhohemi (nëse do të shkruajmë apo jo) te Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Jeni dakord që të procedojmë në këtë mënyrë? Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndërkohë nuk mund ta mbështesim njëzëri, sepse kërkon të kemi njohuri juridike, përpara se të shkruajmë apo të mos shkruajmë diçka. Kjo është një letër publike, i është drejtuar komisionit tonë në formë institucionale.

Fidel Ylli – Njëri bën art, tjetri bën sport, por puna është se nuk kemi asnjë lloj tagri. Ky është buxhet që është i përcaktuar. Ai t'i drejtohet Ministrisë së Kulturës që në projektet që ka kjo e fundit për të mbështetur artin, kulturën, mund të parashikojë një fond që t'ia japë, sepse është zë i saj. Ne nuk kemi asnjë lloj tagri që të diskutojmë. Të shkojë të aplikojë

dhe të marrë fonde. Sh.pk është dhe si e tillë është me qëllim fitimi. Unë do të hap nesër një aktivitet sportiv, në pallatin e sportit, do të marr biletat për të fituar dhe i them shtetit: “Më ndihmo!”. Nuk është OJQ, por edhe për këtë të fundit duhet të aplikoj në ministri, unë kështu mendoj. Dëshira është e madhe, për të mbështetur iniciativa të tilla, por ne duhet të jemi në rregull me ligjin. Që në leximin e parë e kuptoj se zoti Dizdari duhet të aplikojë në Ministrinë e Kulturës, ku janë projektet e tjera për operan, për kulturën, për baletin për gjithçka.

Milva Ekonomi - Faleminderit!

Për nesër ne kemi një axhendë, e kemi draftuar së bashku. Sekretaria ka bërë lajmërimet, kemi diskutimin për projektbuxhetin në parim me sindikatat.

Pastaj kemi një diskutim për një paketë fiskale për një ndryshim fiskal që ka ardhur për TVSH-në e reklamave. Kemi ftuar përfaqësues të Ministrisë së Financave.

Pastaj kemi diskutimin në parim të projektbuxhetit, ku marrin pjesë përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe përfaqësues nga të dyja ministritë për të cilat ne jemi përgjegjës: Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit. Pas tyre kemi dëgjuesën me zotin Bregu, nëse do të kemi përgjigje prej tij.

Kjo është dita e punës për nesër. Do t’ju lutesha edhe një herë që në orën 10:00 të jemi në komision për të mbaruar këtë axhendë.

Fidel Ylli - Në lidhje me procedurat që do të ndiqeshin për zotin Bregu, a u zbatuan, a dolën të gjitha problemet që ngritëm, që kur të vijë në komision, të jemi të qartë? A kemi një informacion?

Milva Ekonomi - Ju sot keni marrë një letër që na ka ardhur me firmën e sekretarit të Përgjithshëm, por ajo që ka ndodhur, ka këtë kronologji: ka ardhur një konstatim, e ka nxjerrë *CNN Albania* për zotin Bregu, nga kryetari i AMA-s, i cili duke marrë këtë indicia, ka bërë një interpretim të ligjit “Për AMA-n”, ligjit “Për konfliktin e interesit” dhe ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”. Ia ka drejtuar zotit Gramoz Ruçi, pra Kuvendit të Shqipërisë. Kuvendi i Shqipërisë e ka marrë letrën dhe nëpërmjet sekretarit të Përgjithshëm ia ka dërguar Shërbimit të Monitorimit, të cilët kanë bërë dy hapa, kanë parë nëse në QKR, ky emër është person fizik, juridik sh.p.k, ka një formë biznesi, nëse është aktive ose jo. Në QKR ka rezultuar një person fizik aktiv, me këtë aktivitetin që lidhet me marrjen e një toke me qira. E ka konfirmuar Ministria e Bujqësisë, në bazë të shkresës që i ka dërguar sekretari i Përgjithshëm. Ata janë përgjigjur: “Po, ka një tokë me qira. Kjo është

kontrata”. Nga pikëpamja juridike, të gjitha hapat janë ndërmarrë. Është kontrolluar në QKR. Kanë shkuar në Ministrinë e Bujqësisë.

Nga ana tjetër është marrë historiku i veprimtarisë së zotit Bregu. Ai ka mandatin e dytë në AMA. Në mandatin e parë ai nuk ka pasur konflikt të tillë interesi. Kontratën e ka nënshkruar në vitin 2005, kur ishte ende në bordin e AMA-s. Tani vazhdon me këtë gjë. Kjo është situata që kemi, sipas Rregullores, por edhe për t’i dhënë mundësinë e të shprehurit dhe të dhënies së shpjegimeve, pse është një situatë të tillë...

Fidel Ylli- Zyra e konfliktit të interesit, a ka kthyer përgjigje?

Milva Ekonomi - Po procedojnë.

Fidel Ylli- Para se të thirret në dëgjese, duhet të kishte sjellë një përgjigje ILDKPKI-ja, sepse ajo është zyra që saktëson nëse ka apo nuk ka konflikt interesi.

Milva Ekonomi - Në këtë situatë jemi.

Problemi që ke ti është se verifikimi është bërë. Pra, ky person ka një aktivitet aktiv dhe ka një kontratë nga Ministria e Bujqësisë. Këto të dyja kanë ardhur. Ndërkohë, është ligji “Për AMA-n”, ligji “Për konfliktin e interesit”. Kur të vijë ai, do ta dëgjojmë dhe, më pas, do të diskutojmë dhe do të marrim një vendim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të bëjmë një përgjigje me letër, pasi të dëgjojmë zotërinë dhe më pas do të procedojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe ne sipas ligjit po veprojmë. Pyetëm sekretarin e Përgjithshëm dhe po veprojmë sipas ligjit. Edhe Sonila, edhe unë, ligjin po zbatojmë. Edhe Ministria e Bujqësisë ligjin po zbaton.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja ku e kemi asistencën. Ka një shërbim të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju hapini e-maillet që na dërgon Ariana dhe tek ato keni edhe letrën e AMA-s, edhe letrën që i është çuar ministrisë përkatëse, edhe shkresën e QKR-së që e ka zbuluar, edhe përgjigjen që i ka dhënë sekretari i Përgjithshëm komisionit tonë. Ai na e ka sjellë ne për fillimin e procedurës. Domethënë, të gjitha këto i keni të kopsitura.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Konfliktin e interesit e ka automatikisht nga ligji.

Fidel Ylli – Po përse nuk e sjell mendimin ILDKPKI-ja? Nuk duhet ta pyesim ne atë paraprakisht?

Milva Ekonomi – Ju them, se i ka ligji.

Fadil Nasufi – Fideli ka të drejtë. Përderisa vijnë dokumentet nga institucionet ligjore, nuk kemi pse të marrim vendim ne. Ne kemi edhe rastin në parlament, kur kanë ikur deputetët, nga formulari i dekriminalizimit, por parlamenti nuk është shprehur për asgjë. Ai ka dalë nga atje dhe ka ardhur një deputet tjetër në vend të tij. Edhe në rast se ka bërë betimin, ka ikur. Pse duhet ta bëjmë ne gjykimin? Ne mund ta dëgjojmë, por nuk kemi pse të marrim vendim, përderisa institucioni përkatës thotë që ka konflikt interesi. Pikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ai do të thotë të vetat dhe ti do të thuash të tuat. Më pas, do të shohim se si do të veprojmë. Në këtë moment na ka ardhur nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit kjo çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Duhet të kemi të gjitha dokumentet dhe pastaj do të ulemi të dëgjojmë. Mungon dokumenti kryesor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nga ILDKPKI-ja.

Milva Ekonomi – Më dëgjo pak!

Formularin e ILDKPKI-së e plotësojmë mbi baza personale. Unë shprehem personalisht, deklaroj pasurinë time. Ne kemi informacion për pasuri që ai i ka marrë në raport me institucionet e treta të vendit, se QKR-ja dhe Ministria e Bujqësisë janë të treta. Formularin e ILDKPKI-së ai e ka plotësuar mbi baza personale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ashtu është, sepse ai është deklarim personal.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta shikojmë, do të na e thotë ai. Kur ta thotë ai këtë gjë, do të marrim ne një vendim. A e kuptoni logjikën? Do të shprehesh për këtë gjë.

Po e them edhe një herë që ta kuptoni: është një indicie e ardhur nga shtypi, e cila u verifikua nga dy burime. Për këtë arsye ne duam ta thërrasim atë zotërinë, sepse ai mund të thotë që këtë gjë e ka vënë te formulari i ILDKPKI-së, apo ka harruar ta vërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar Çela – Unë mendoj se kemi për detyrë të shprehemi, meqë na janë drejtuar me shkresë. Ne nuk e dënojmë, as atyre nuk u japim ndonjë lek për të bërë godinat, por kemi për detyrë të japim mendim.

Kur ILDKPKI-ja ta marrë prej veshi, ai e ka të zgjidhur. Problemi është që ai ka shkelur ligjin, ka tjetërsuar aktivitetin dhe është në konflikt interesi. Edhe Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Ekonomisë e dinë. Edhe ata që kanë ardhur dje tek ne, do të njihen.

Ne do të japim një mendim, as do ta varim, as do ta shpëtojmë.

Sonila Kadare – ILDKPKI-ja është institucion qendror për monitorimin dhe për zbatimin e ligjit të rasteve të shkeljeve që konstatohen për të gjithë zyrtarët në RSH-së, të cilët janë objekt i këtij ligji, por ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ka disa hapa, që përcaktojnë institucionet, të cilat merren me trajtimin e ligjit.

E kemi thënë edhe herë të tjera se institucioni parësor është vetë institucioni ku punon zyrtari, që ka autoritetin e tij përgjegjës, burimet njerëzore etj., sepse ka një strukturë aty. Ashtu siç shkoni ju deputetët te Sektori i Trajtimit të Deputetëve dhe dorëzoni deklaratat, apo siç është bërë tani edhe regjistri i konfliktit, për të cilin u bë simpoziumi, ku ju do të trajtoheni, po kështu është për ata zyrtarë, të cilët kanë burimet njerëzore, ku japin dhe marrin.

Përveç institucionit është edhe institucioni tjetër, në rastin kur e zgjedh dikush tjetër. Ky nuk është një zyrtar që punësohet me një akt të thjeshtë, por ai është i zgjedhur, i mandatuar nga Kuvendi dhe nga komisioni, që janë institucione eprore, të cilat nuk përjashtohen nga konstatimi i faktit, trajtimi i rastit dhe nga zgjidhja e pasojave.

ILDKPKI-ja është një ndër këto institucione dhe mund të japë edhe ajo komentet e saj dhe të veprojë në rastin e zgjidhjes së pasojës. Ajo vihet në lëvizje edhe kryesisht, kur e sheh botërisht, por edhe nga vetë shkresa që mund t’i çohet nga institucioni përkatës dhe më pas vazhdohet me masat që ka ligji, me procedurat administrative, sepse ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, përcakton edhe disa hapa aty: shfuqizimin e aktit, dhënien e gjobës. Pra, ILDKPKI-ja e trajton rastin edhe në aspektin administrativ.

Ndërkohë, në aspektin e shkeljes disiplinore vetë ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të njeh ty, nëse do të marrësh masën. Pra, nuk jemi në hapat e atyre 10 metodologjive që përcakton neni 37 dhe neni 38 i këtij ligji,

sepse nuk je në kushtet e konstatimit, apo të parandalimit, por je në kushtet që ka 3 vjet që është krijuar pasoja, pra si të thuash, është rënduar edhe shkelja.

Ty të ka ardhur një kërkesë nga kryetari i AMA-s dhe nuk mund të qëndrosh indiferent dhe të mos nisësh edhe ti veprimet, sepse qëkur e zgjedh, e zgjedh në bazë të integritetit dhe në bazë të disa kriterëve profesionale, morale etj., detyrimit që ka ky zyrtar që të punojë vetëm për atë funksion publik për të cilin e ke ngarkuar dhe të mos e shkelë legjislacionin. Ky është një legjislacion, i cili zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pra jo vetëm ligji organik që ai ka, por edhe ligji tjetër, që është ky ligj për konfliktin e interesave.

Rasti në çdo lloj kohe që mund t'ia çoni, ILDKPKI-ja do të marrë masat e veta. Kështu nuk e përjashtojmë apo atakojmë edhe vendimmarrjen tuaj. Është në vlerësimin tuaj se në cilin moment ju do t'ia çoni ILDKPKI-së, që ta trajtojë, ta regjistrojë si rast, ta fusë në statistikën e veta, t'i japë masat e veta administrative në këtë rast, sepse i bie të shfuqizohet akti. Këto nuk i bëni ju. Ju keni të drejtën që siç e zgjidhni, të bëni edhe formalizimin e aktit final të shkarkimit.

Për shembull, një rast i ngjashëm është rasti i vitit 2009 të një anëtari të organit të atëhershëm, AMA e sotme, Detar Hysit. U iniciua si indicie nga vetë ILDKPKI-ja, e cila konstatoi gjatë kontrollit se ai ishte në shkelje të ligjit për deklarimin e pasurisë dhe ishte në konflikt interesi. Erdhi shkresa dhe ai u trajtua dhe u shkarkua nga komisioni në atë kohë, për shkak se komisioni mori këtë informacion, në zbatim të ligjit të deklarimit të pasurisë dhe shkeljes së konfliktit të interesit. Komisioni vendosi ta shkarkojë, pasi konstatoi shkeljen me arsyetimin se ai ishte autoriteti që zgjedh, ai është autoriteti që shkarkon, me të njëjtën bazë ligjore, siç mund të veprohet edhe sot. Atëherë, ishte neni 15 i ligjit nr. 8410, ndërsa sot është neni 12, i ligjit nr. 97/2013. Megjithatë...

Musa Ulqini – Për sa kohë ne jemi komisioni që e kemi zgjedhur dhe e kemi bërë këtë mbi bazën e disa kriterëve, kemi bërë një seancë dëgjimore, kemi bërë verifikime, kemi dërguar shkresa dhe na janë kthyer përgjigjet, përveç deklarimeve që ka bërë këtu secili nga të zgjedhurit, ne kemi detyrimin të shprehemi për këtë çështje. Ne nuk marrim masë për t'i vënë gjobë. Ajo është një e drejtë e institucionit tjetër. Ai është zgjedhur nga ne dhe ne kemi detyrimin të shohim nëse ky i zgjedhur nga ne ka shkelur kërkesat për të cilat ne duhet të shprehemi, sepse ne jemi institucioni përgjegjës. Ne duhet të shprehemi. Ne mund të themi që ai të shkarkohet dhe të fillojmë procedurën për të zgjedhur një tjetër anëtar. Ky është detyrimi ynë. Natyrisht, ne kemi të drejtë të kërkojmë nga institucionet përkatëse shkresat e

nevojshme. Nga 2 materialet që unë kam lexuar, ai është fakt, është i provuar shkencërisht, saktësisht, ligjërisht, sepse kanë ardhur provat që e dëshmojnë një gjë të tillë.

ILDKPKI-ja nuk duhet thjesht të shprehet, nëse ka apo nuk ka konflikt interesi, por duhet t'i vërë gjobë sipas atyre kritereve.

Ne me shkresën dhe me dokumentet që kemi, jemi të bindur që ai e ka shkelur ligjin. Është shumë e qartë, që ai është në konflikt interesi. Ne e kemi provën, dokumentin dhe kemi detyrimin të shprehemi për një njeri që është zgjedhur nga ne në një institucion shumë të rëndësishëm. Kjo çështje është shumë e qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne, si komision, kemi detyrimin tonë për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Së bashku me Musain ishim në një mendje të gjithë që jemi dakord, por kryetari i AMA-s nuk mund t'i nxjerrë gështenjat me duart tona. Kjo do të thotë që kryetari i AMA-s duhet t'i bëjë letër Kuvendit dhe më pas ne të fillonim kërkimin. Ai t'i bënte gati dhe të na i sillte në këtu. Padyshim, ne do të shprehemi. Ne do të shkojmë te ILDKPKI-ja, por do të shkojmë më pas. Të jesh i sigurt, që ne do të shkojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, ata duhet t'i çonin një letër ILDKPKI-së dhe ai të na thoshte nëse ka shkelje apo nuk ka. Gjoka është gjë tjetër. Ne duhet ta kishim të gjithë dosjen të plotë. Unë këtë problem ngrita.

Milva Ekonomi – ILDKPKI-ja të tregon nëse e ke deklaruar apo jo. Unë nuk e deklaroj dhe ti nuk e di se çfarë kam unë. Unë mund të kem bërë një deklaram në ILDKPKI. Kur të më vijë radha mua, si individ, që të më shohë ILDKPKI-ja nëse kam apo nuk kam konflikt interesi, se mund të mos jem te transhi i parë i verifikimit, por mund të jem te transhi i tretë i verifikimit, ndërkohë koha kalon: edhe koha që ai punon te AMA, kalon.

Ne bëme verifikime të jashtme, jo të personit, por nga institucionet që veprojnë me personin dhe këto institucione kanë deklaruar që ka shkelje. Tani ta thërrasim atë zotërinë këtu, se mund të mos jetë e vërtetë. Kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është çështja. Nesër kemi një mbledhje që në orën 10:00 dhe këtë person e kemi lajmëruar për në orën 13:00. Dakord?

MBYLLET MBLEDHJA

